



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITRN	
02 Nr. / Br	1485/22
Nr. i fq. / Br. sh	
Data: / Datum	22.11.2022
VUSHTRRI - VUČITRN	



Komuna Vushtri

KRM.Uniteti – Mitrovicë

Bazuar në nenin 21 të Marrëveshjes për Shërbime Primare të Menaxhimit të Mbeturinave në Territorin e Komunës së Vushtrrisë Nr. 739/21 datë 30.06.2021 në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe KRM “Uniteti” në Mitrovicë me datën 22.11.2022 lidhet:

**ANEKSI I TRETË I MARRËVESHJES
PËR SHËRBIME PRIMARE PËR MENAXHIM TË MBETURINAVE NË TERRITORIN
E KOMUNËS SË VUSHTRRIË**

Palët e marrëveshjes:

Komuna e Vushtrrisë, të cilën e përfaqëson **z. Ferit Idrizi**, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë (në tekstin e mëtejme komuna).

KRM “Uniteti”, në Mitrovicë, të cilën e përfaqëson **z. Gazmend Morina**, Kryeshef Ekzekutiv (në tekstin e mëtejme “Uniteti”).

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Aneks marrëveshje është ofrimi i shërbimeve shtesë në rrugët dhe hapësirat publike në qytet, nga KRM “Uniteti” në Mitrovicë, për periudhën kohore nga dita e nënshkrimit të kësaj aneks marrëveshje deri më 31 dhjetor 2022, bazuar në marrëveshjen bazë Nr. 739/21, dt. 30.06.2021 me shtojcat A, B dhe C në mes të KRM “Uniteti”, në Mitrovicë, dhe Komunës së Vushtrrisë.

**Neni 2
Ndryshimi dhe Plotësimi i Shtojcës “C” të marrëveshjes bazë**

1. Shtojca “C” e marrëveshjes bazë ndryshohet dhe plotësohet si vijon:
 - 1.1 Në tabelën Nr. 1 – **Pastrimi (fshirja) e rrugëve së bashku me trotuaret**, pas pozicionit të fundit (pozicionit të tetë) shtohet pozicion shtesë me këtë tekst:
“Pastrimi (fshirja) i Sheshit “Hasan Prishtina” me sipërfaqe prej 1920 m² si dhe sheshit “Ahmet Krasniq” në sipërfaqe prej 1770 m², që të dy sheshet 6 herë në javë ,

deri më 31 dhjetor 2022” në vlerë prej 2,550.52 € (dymijë e pesëqind e pesëdhjetë euro e pesëdhjetë e dy cent).

1.2 Në tabelën Nr. 3 “**pastrimi (larja) e rrugëve të qytetit**” - pas pozicionit të fundit (pozicionit të njëzetegjashtë) shtohet pozicioni shtesë me këtë tekst: “pastrimi (larja) 12 herë deri më 31 dhjetor 2022 e sheshit “Hasan Prishtina” me sipërfaqe prej 1920 m² si dhe pastrimi (larja) poashtu 12 herë deri më 31.12.2022 e sheshit “Ahmet Krasniqi” në sipërfaqe prej 1770 m²” që të dy sheshet në vlerë prej 3,453.84 € (tremijë e katërqind e pesëdhjetë e tri euro e tetëdhjetë e katër cent).”

Neni 3

Pagesa për kryerje të punëve

- 4.1 KRM “Uniteti” në Mitrovicë, për shërbimin e kryer në nenin paraprak do të kompensohet me mjete financiare në shumë prej gjithsejtë 6,004.36 € (gjashtëmijë e katër e tridhjetegjashtë cent).
- 4.2 Pagesa e mjeteve do të bëhet nga buxheti i Komunës, mallra dhe shërbime – nga njësia buxhetore në të cilën ka mjete të lira.
- 4.3 Pagesa do të bëhet pas dorëzimit të faturës dhe raportit të komisionit mbikëqyrës, për punët e kryera.

Neni 4

Mbikëqyrja

Mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj aneks marrëveshje do ta bëj komisioni i caktuar në marrëveshjen bazë.

Neni 5

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në rast kontesteve eventuale lidhur me dispozitat e kësaj aneks marrëveshje mirëkuptimi, palët do të zgjidhin me marrëveshje, nëse kjo nuk mund të arrihet kontesti do të zgjidhët në Gjykatën kompetente.

Neni 6

Kopje

Kjo Aneks Marrëveshje është hartuar në dy (2) kopje origjinale, ku secila palë nënshkruese merr nga një (1) kopje.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit



Gazmend Morina

Kryeshef Ekzekutiv